
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____._____.2026

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “**MEKTRIN MOTORS**” shpk, me NUIS: **K51408501P**, me adresë: “*DURRES AUTOSTRADA KM.6 XHAFZ.*”.

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: Mallra

Lloji i Procedurës së prokurimit: E hapur, mbi kufirin e lartë monetar.

Referenca e Lotit: REF-67990-11-06-2025.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje autoambulanca (me sisteme, pajisje dhe aparatura mjekësore) për shërbimin e urgjencës për QKUM”, me afat zbatimi brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.

Data e Publikimit në SPE, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit: 23.12.2025.

Data e Publikimit në Buletin e Njoftimeve Publike, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit: Buletini Nr. 83 datë 29 Dhjetor 2025.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari, ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me vlerat përkatëse të ofruara:

1. OE “TIMAK” SH.P.K**L62030020B***Emri i plotë i shoqërisë**Numri i NIPT-it*

Vlera: 112,190,000 (njëqind e dymbëdhjetë milion e njëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO XNëse po, të jepen dhënat _____*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)***2. OE “VIBTIS” SH.P.K****L02103503S***Emri i plotë i shoqërisë**Numri i NIPT-it*

Vlera: 128,000,000 (njëqind e njëzet e tetë milion) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO XNëse po, të jepen dhënat _____*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)***3. OE “MEKTRIN MOTORS” SH.P.K****K51408501P***Emri i plotë i shoqërisë**Numri i NIPT-it*

Vlera: 131,313,000 (njëqind e tridhjetë e një milion e treqind e trembëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO XNëse po, të jepen dhënat _____*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)***4. BOE “Albadent Group” SH.P.K****L62217032L (70%) &****“Avel” SH.P.K****K31407010A (30%)***Emri i plotë i shoqërisë**Numri i NIPT-it*

Vlera: 139,666,007 (njëqind e tridhjetë e nëntë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatë) lekë pa TVSH.

Adresa: Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë) www.obp.al

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

5. BOE “GTS-Gazra Teknike Shqiptare” SH.P.K J61905015B (15%) &

“EDM” S.R.L Vat

04155170402 (85%)

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: 142,480,000 (njëqind e dyzet e dy milion e katërqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. OE “TIMAK” SH.P.K

L62030020B

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: 112,190,000 (njëqind e dymbëdhjetë milion e njëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Operatori ekonomik "**TIMAK**" **SHPK**, **Nipt L62030020B**, me dokumentacionin e paraqitur nuk vërteton se i përmbush kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit për arsye si mëposhte :

- Nuk përmbush kriterin e vecante të kualifikimit, piken 2, nenpiken 1, shkronjen a) pasi nuk ka dhënë asnjë indicie për institucionin (adresën përkatëse) apo dokumentacionin konkret mbi bazën e cilit do të kryhet verifikimi për këto rubrika, në Pjesën II: Shkaqet e përjashtimit A: **DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**, në Formularin e Permblledhes të Vetdeklarimit, për të gjitha Seksionet përkatëse si mëposhte:
 - *Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.*

- *Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.*
- *Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:*
nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.
- *Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.*
- *Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).*
- *Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.*
Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- *Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.*
- *Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.*
- *Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.*
- *Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.*
- *Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.*
Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- *Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.*

Theksojme që ne mbështetje të LPP, Rregullave të Prokurimit Publik dhe qëndrimit të mbajtur nga KPP me ane të vendimit Nr.209/2025, date 07.02.2025 dhe vendimit Nr 816/2025, date 27.06.2025, Formulari Permblidhës i Vetedeklarimit duhet të plotësohet në të gjithë seksionet e saj duke dhënë indicie për institucionin (adresën përkatëse) apo dokumentacionin konkret mbi bazën e cilit do të kryhet verifikimi për këto rubrika

- Nuk permbush kriterin e vecante te kualifikimit, piken 2, nenpiken 1, shkronjen a) pasi nga shqyrtimi i formularit Permbledhes te Vetedeklarimit te ngarkuar ne SPE konstatohet se “Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit”, “A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT”, rezulton se nuk është deklaruar për personin në cilësinë e Administratoren, Znj. Manjola Kasneci dhe ortakun Znj. Arjeta Puca, në kundërshtim me sa kërkohet në këtë formular sipas të cilit: *Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik [...] duhet të deklarohen se nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së,* etj. Znj. Manjola Kasneci ne cilesine e administratorit dhe detyrimisht duhej deklaruar në “Shkaqet e përjashtimit”, “Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit”, si më sipër cituar. Administratori i një kompanie konsiderohet person që përfshihet në kategorinë e parashikuar nga formulari përmbledhës i vetedeklarimit per arsyen sepse ka kompetenca perfaqesuese te operatorit ekonomik. Me konkretisht dhe ne kete procedure ne cilesine e administratorit Znj. Manjola Kasneci ka firmosur Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit, Oferten ekonomike, deklaratat e kerkuara etj pra rrjedhimisht Adminstratori hyn te personat që duhet të vetëdeklarojnë, njësoj si anëtarët e organit administrativ, aksionarët kryesorë apo ortakët. Gjithashtu dhe Znj. Arjeta Puca ne cilesine e ortakut detyrimisht duhej deklaruar në “Shkaqet e përjashtimit”, “Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit”, si më sipër cituar.

Qendrim i mbajtur dhe nga Komisioni i Prokurimit Publik me ane te vendimit Nr 1375/2025, date 02.10.2025.

- Gjithashtu referuar dokumentacionit të paraqitur rezulton se shoqëria “A V E L” shpk është importuesi zyrtar për automjetet Peugeot për Shqipërinë (sipas Autorizimit të Prodhuesit “Peugeot” dhe Distributorit Zyrtar të Autorizuar nga Prodhuesi “EUROIMPEX DOO Skopje”).

Pra, në të njëjtën kohë shoqëria “A V E L” shpk në cilësinë e importuesi zyrtar për automjetet Peugeot për Shqipërinë ka autorizuar shoqërinë “TIMAK” shpk për të marrë pjesë dhe për të ofertuar në këtë procedurë prokurimi (REF-67990-11-06-2025) me automjet Peugeot.

Për sa më sipër, KVO vlerëson konstatimin e kushteve të ndërhyrjes në ofertë sipas parashikimeve të nenit 81 të VKM nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, pasi shoqëria “A V E L” shpk në cilësinë e importuesit dhe distributor zyrtar të automjeteve Peugeot për Shqipërinë, rezulton të jetë shoqëria e cila ka tagrin dhe mundësinë për përcaktimin e çmimit të automjeteve Peugeot në Republikën e Shqipërisë dhe si e tillë në rastin konkret ka marrë pjesë në procedurën e sipërcituar jo vetëm nëpërmjet ofertës së paraqitur drejtpërdrejt prej saj por në mënyrë indirekte edhe nëpërmjet ofertës së paraqitur nga shoqëria “TIMAK” shpk.

Për sa më sipër, deklarimet e bëra në formularin e vetedeklarimit nga shoqëria, “Seksioni B: DEKLARATA Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura” seksionin “Kam përgatitur ofertën në

mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër”, bëhen të pavlefshme dhe të paqenësishme, pasi në kuptim të këtij parashikimi:

“fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë”,

Në kushtet kur ky operator ka rakorduar për përcaktimin e çmimit me të vetmin distributor zyrtar të Peugeot në Shqipëri, i cili ka marrë pjesë në procedurë si konkurrent dhe të dy kanë ofertuar në procedurë, është fakt që tregon konsultime dhe përgatitje të ofertës jo në mënyrë të pavarur.

2. OE “Vibtis” SH.P.K

L02103503S

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: 128,000,000 (njëqind e njëzet e tetë milion) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Operatori ekonomik **"Vibtis" Shpk, Nipt L02103503S**, me dokumentacionin e paraqitur nuk vërteton se i përmbush kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit per arsyet si mëposhte :

➤ Nuk përmbush kriterin e vecante te kualifikimit, piken 2.3.2 pasi referuar CoC te ngarkuar ne SPE ne përmbushje te pikes 2.3.6 konstatohet qe OE ka ofruar automjete Fiat Ducato nderkohe nuk ka paraqitur autorizim nga prodhuesi /ose distributori i autorizuar per keto automjete per me teper autorizimi i prodhuesit i leshuar nga kompania turke prodhuese e autoambulancave "Kurtaran Ambulans" nuk e ploteson kriterin kualifikues sepse kompania turke thjesht prodhon ambulancen si produkt final duke i vendosur aksesoret e percaktuara ne Shtojcen 6 "Formulari i Specifikimeve Teknike" automjetit minibus (furgon me dritare) sic eshte kerkuar ne DST, por nuk eshte prodhues /ose distributori i autorizuar i automjetit mbi te cilin do te vendosen aksesoret e percaktuara Ne sShtojcen 6 per te bere produktin final **"Autoambulance"**.

Qendrim i mbajtur dhe nga Komisioni i Prokurimit Publik me ane te vendimit Nr 1183/2025, date 03.09.2025.

➤ Nuk përmbush kriterin e vecante te kualifikimit, piken 2.3.5 pasi referuar CoC te ngarkuar ne SPE ne përmbushje te pikes 2.3.6 konstatohet qe OE ka ofruar automjete Fiat Ducato nderkohe qe ka paraqitur katalog nga kompania turke prodhuese e autoambulancave "Kurtaran Ambulans"e cila nuk eshte prodhuese/ose distributori i autorizuar per kete automjet, per me teper dhe ne kete katalog nuk konstatohet qe te jete automjeti i ofertuar Fiat Ducato ku te mund te evidentohen te dhenat teknike.

3. BOE “Albadent Group” SH.P.K
“Avel” SH.P.K
Emri i plotë i shoqërisë

L62217032L (70%) &
K31407010A (30%)
Numri i NIPT-it

Vlera: 139,666,007 (njëqind e tridhjetë e nëntë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

BOE e perbere nga "Albadent Group" shpk, Nipt L62217032L 70% & "Avel" Shpk, Nipt K31407010A 30%, me dokumentacionin e paraqitur nuk vërteton se i përmbush kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit për arsyet si mëposhte:

➤ Anetari i BOE “Albadent Group” Shpk, NUIS L62217032L nuk përmbush kriterin e vecante të kualifikimit, pikën 2, nën pikën 1, shkronjën a) pasi nga shqyrtimi i formularit Përmbledhës të Vetedeklarimit të ngarkuar në SPE konstatohet se “Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit”, “A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT”, rezulton se nuk është deklaruar për personin në cilësinë e Administratorin, Znj. Artemisa Sokoli, në kundërshtim me sa kërkohet në këtë formular sipas të cilit: *Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik [...] duhet të deklarohen se nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.* Znj. Artemisa Sokoli në cilësinë e administratorit dhe detyrimisht duhej deklaruar në “Shkaqet e përjashtimit”, “Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit”, si më sipër cituar. Administratori i një kompanie konsiderohet person që përfshihet në kategorinë e parashikuar nga formulari përmbledhës i vetedeklarimit për arsyen sepse ka kompetenca përfaqësuese të operatorit ekonomik. Me konkretisht dhe në këtë procedurë në cilësinë e administratorit Znj. Artemisa Sokoli ka firmosur Formularin Përmbledhës të Vetedeklarimit, Oferten ekonomike, deklaratat e kërkuara etj pra rrjedhimisht Administratori hyn te personat që duhet të vetëdeklarojnë, njësoj si anëtarët e organit administrativ, aksionarët kryesorë apo ortakët.

Qendrim i mbajtur dhe nga Komisioni i Prokurimit Publik me anë të vendimit Nr 1375/2025, datë 02.10.2025.

➤ Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Albadent Group” shpk dhe “A V E L” shpk skualifikohet edhe për shkak se:

- Referuar Autorizimeve të paraqitura rezultoi se shoqëria “A V E L” shpk është importuesi zyrtar për automjetet Peugeot për Shqipërinë (sipas Autorizimit të Prodhuarit “Peugeot” dhe Distributorit Zyrtar të Autorizuar nga Prodhuari “EUROIMPEX DOO Skopje”).

Njëkohësisht shoqëria “A V E L” shpk në cilësinë e importuesi zyrtar për automjetet Peugeot për Shqipërinë ka autorizuar shoqërinë “TIMAK” shpk për të marrë pjesë dhe për të ofertuar në këtë procedurë prokurimi (REF-67990-11-06-2025) me automjet Peugeot.

Për sa më sipër, KVO vlerëson konstatimin e kushteve të ndërhyrjes në ofertë sipas parashikimeve të nenit 81 të VKM nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, pasi shoqëria “A V E L” shpk në cilësinë e importuesit dhe distributor zyrtar të automjeteve Peugeot për Shqipërinë, rezultoi të jetë shoqëria e cila ka tagrin dhe mundësinë për përcaktimin e çmimit të automjeteve Peugeot në Republikën e Shqipërisë dhe si e tillë në rastin konkret ka marrë pjesë në procedurën e sipërcituar jo vetëm nëpërmjet ofertës së paraqitur drejtpërdrejt prej saj por në mënyrë indirekte edhe nëpërmjet ofertës së paraqitur nga shoqëria “TIMAK” shpk.

Për sa më sipër, deklaratimet e bëra në formularin e vetëdeklarimit nga shoqëria “A V E L” shpk në “Seksioni B: DEKLARATA Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura” seksionin “Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër”, bëhen të pavlefshme dhe të paqenësishme, pasi në kuptim të këtij parashikimi:

“fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë”,

Në kushtet kur ky operator është distributor zyrtar i Peugeot dhe në këtë cilësi ka autorizuar OE “TIMAK” shpk për të marrë pjesë në procedurë si konkurrent dhe të dy kanë ofertuar në procedurë, është fakt që tregon konsultime dhe përgatitje të ofertës jo në mënyrë të pavarur.

4. BOE “GTS-Gazra Teknike Shqiptare” SH.P.K J61905015B (15%) &

“EDM” S.R.L Vat

04155170402 (85%)

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: 142,480,000 (njëqind e dyzet e dy milion e katërqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

BOE e perbere nga "GTS" Shpk, Nipt J61905015B 15% & "EDM" s.r.l Vat 04155170402 85%, me dokumentacionin e paraqitur nuk vërteton se i përmbush kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit për arsye si mëposhte :

- BOE "GTS" Shpk, Nipt J61905015B 15% & "EDM" s.r.l Vat 04155170402 85% nuk përmbush kriterin e vecante të kualifikimit, piken 2.3.3 pasi nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE në përmbushje të këtij kriteri konstatohet që OE "GTS" Shpk, NUIS J61905015B për servisin “Alfred Shehu” PF me të cilin ka kontratë shërbimi, ka paraqitur Licencën me kod

VII.3.B.1 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, licence e cila është për piken “a” por nuk përfshin dhe pikat “b, c, ç” të kërkuara në këto kriter në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr.1546, datë 29.03.2016, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove” dhe me legjislacionin për lejet dhe licencat, për ambientin ku ushtron këtë aktivitet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “**MEKTRIN MOTORS**” shpk, me adresë: “*DURRES AUTOSTRADA KM.6 XHAFFZ*”, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **131,313,000** (njëqind e tridhjetë e një milion e treqind e trembëdhjetë mijë) lekë pa TVSH është identifikuar si oferta fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore**, me adresë: *Rruga “Lord Bajron”, Nr.70, Tiranë*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda afatit që do t’iu njoftohet nga autoriteti kontraktor përfutës.

Nëse nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t’ju konfiskohet siguri i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO **X** JO ☐

Nëse Po (Nr. __ Datë __ i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik)

- Vendimi nr. 205 datë 04.02.2026 i Komisionit të Prokurimit Publik.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR